

## AKTI I THEMELIMIT

### I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “Primo Invest ” SH.P.K

Themeluesit që firmosin më poshtë :

**Shoqëria "ALFAZED" Sh.P.K**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) J82229006N, datë 28/10/1998, me seli në Tiranë, Rruga "Sami Frashëri", P.13, Hyrja 10. Ap. Nr. 29, përfaqësuar nga Administrator znj.**Shefikat Ngjela**, atësia Jasin, shtetase Shqiptare, lindur në Delvine, Sarandë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga e Kavajes; Njësia Administrative Nr.10; Njesia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 07/02/1956, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajës e Leternjoftim ID Nr. 033860101 dhe Nr. personal F65207034A .

**Shoqëria " PRIMO GROUP" Sh.P.K**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) M17829502M, datë 29/04/2021, me seli në Lezhë, Shëngjin, Rruga "Nënë Tereza", Qendër Shëngjin, godina Nr.22, Kati 1, përfaqësuar nga Administrator z. **Ervis Rrjollli**, atësia Fran, shtetas Shqiptar, lindur në Laç, dhe banues në Laç, i datëlindjes datë 28/03/1982, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftim ID Nr. Personal I203281070,

që në vijim do të quhen ‘Ortakë’

Sot me date 15 Mars 2024 (dymje e njezet e kater), bazuar në vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14/04/2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, vendosën të themelojnë Shoqërinë Tregëtare me Përgjegjësi të Kufizuar, në bazë të kushteve që vijojnë :

#### Kreu I

#### OBJEKTI, EMËRTIMI, SELIA, RREGJIMI JURIDIK

##### Neni 1. Objekti i Shoqërisë

Shoqëria ka këtë Objekt të veprimtarisë :

-Fusha e Ndërtimeve. Ndërtime të objekteve civile dhe industriale. Tregëtim materjale të ndryshme ndërtimi, inerte, mermer, elektrike, hidraulike, makineri e pjesë këmbimi për lloje të ndryshme të makinerive. Ndërtim dhe menaxhim i objekteve turistike. Ndërtime rrugore, ndërtime hidroteknike, rikonstruksione godinash civile. Projektim, zbatim mirëmbajtje të objekteve të ndryshme. Punime ndërtimi, instalime impjantesh të ndryshëm, lyerje, patinim, dyer, dritare, etj.

- Veprimtari në fushën Imobilare, marrje, dhënia me qira, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Konsulencë, shitje-blerje, të pasurive të paluajtshme, të luajtshme.
- Konsulencë për investime në Pasuri Reale; Konsulencë Shitjesh e Marketing ;
- Administrim Pasurie për llogari të të tretëve ;
- Import-Eksport të gjithë produkteve të lejuara nga legjislacioni, shitje e blerje e automjeteve dhe dhenie me qira.
- Transport brenda dhe jashtë vendit; të udhëtarëve dhe mallrave, agjensi udhëtimesh dhe turistike.
- Përfaqësime kompanish të ndryshme ndërkombëtare, ekskluzivitete apo ndërmjetësime kompanish ndërkombetare, në të gjithë fushat,
- Në përputhje me legjislacionin shqiptar, me qëllim arritjen e objektivave të mësipërme, shoqëria mund të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme apo ato të paluajtshme, të drejta dhe pjesëmarrje me aksione, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, të japë dhe të marrë me qira, të vendosë pengje dhe barre hipotekore, aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë qëllimin dhe vetë natyrën e aktiviteteve kryesore, të cituara më sipër;
- Shoqëria do të kryejë çdo lloj aktiviteti që hyn në objektin e saj dhe që e ndihmon të arrijë qëllimet e saj. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standardet më të larta të etikës dhe Ligjet në Republikën e Shqipërisë.

## **2. Emërtimi dhe Selia juridike e Shoqërisë .**

**2.1-Ortakët** vendosën të emërtojnë Shoqëria **“Primo Invest”** Sh.P.K.

**2.2-Selia** juridike e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Rruga "Lord Bajron", Zona Kadastrale Nr.8310, pasuria Nr. 5/507.

**2.3-Shoqëria** mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose edhe jashtë vendit.

**2.4-Vendodhja** e ortakëve në marrdhënie me Shoqërinë do të jetë ajo që rezulton e shënuar në librin e Shoqërisë.

## **Neni 3. Rregjimi Juridik**

**3.1-Shoqëria** është shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit, si dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**3.2-Me vendim** unanim Ortakët mund të ndryshojnë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorëshme për funksionimin e saj sipas ligjit shqiptar. Në këtë rast Ortakët do të përshtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe të bëjnë rregjistrimin e saj në rregjistrin tregtar, në organet kompetente shqiptare.

**3.3-Shoqëria** gëzon personalitet juridik, nga data e rregjistrimit të saj në QKB, në organet kompetente dhe në përputhje me Ligjin.

3.4-Shoqëria do të ketë vulën e saj.

## Kreu II

### TË DREJTAT DHE DETYRAT, KOHËZGJATJA

#### Neni 4. Të Drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakëve .

4.1-Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

4.2-Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3-Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak në shoqëri ose ndërmarje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin në Republikën e Shqipërisë.

4.4-Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj, duke përjashtuar shprehimisht çdo përgjegjësi personale të çdo ortaku.

4.5-Ortakët përballojnë humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

4.6-Ortakët marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit e Statutin, vetë, ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij.

4.7-Ortakët kanë të drejtë të marrin të gjithë informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike, kontratat e lidhura me të tretë, etj .

4.8-Ortakët kanë të drejtë të bëjnë propozime dhe ti paraqesin ato për shqyrtim para organeve të shoqërisë, si dhe të emërojnë e shkarkojnë administratorin, ose administratorët, punonjësit, ekspertin kontabël apo likuidatorët.

4.9-Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga Shoqëria duke ia ofruar pjesën e tyre të kapitalit themeltar ortakëve të tjerë. Pjesët e kapitalit mund t'u ofrohen të tretëve, vetëm në qoftë se ortakët e tjerë nuk pranojnë t'i blenë ato. Heqja dorë nga Shoqëria nuk e liron Ortakun nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj Shoqërisë dhe nuk pezullon detyrimet ndaj ortakëve.

4.10-Çdo ortak ka të drejtë të jetë ortak edhe në shoqëri të tjera, duke plotësuar detyrimet brenda Shoqërisë, të përcaktuar në Aktin e Themelimit, Statutin, dhe legjislacionin në fuqi.

#### Neni 5. Detyrimet e Ortakëve .

**5.1-**Çdo ortak detyrohet të sigurojë plotësimin e drejtë, të plotë dhe në kohë të detyrimeve të veta ndaj Shoqërisë dhe ortakëve të tjerë, në bazë të Aktit të Themelimit, Statutit, legjislacionit në fuqi.

**5.2-**Kur ortaku nuk i përgjigjet drejtë dhe në mënyrë të plotë detyrimeve financiare ose detyrimeve të tjera, atëherë ortaku tjetër e fton me shkrim që t'i plotësojë ato detyrime brenda 10 ditëve. Nëqofëse nuk pranon, atëherë ortaku i prekur ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin. Niveli i dëmshpërblimit do të jetë përkatësisht me dëmin e shkaktuar. Ekspertët kontabël mund të caktojnë ekzaktësisht nivelin e dëmshpërblimit.

## **Neni 6. Kohëzgjatja**

**6.1-**Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar 15 Vjet ( pesëmbëdhjetë vjet).

## **Kreu III**

### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

#### **Neni 7.**

**7.1-**Kapitali Themeltar i shoqërisë është 20.000 Lekë (njëzet mijë Lekë ). Kapitali i shoqërisë është nënshkruar e derdhur tërësisht në të holla, i ndarë në dy kuota.

**7.2-**Kapitali themeltar i ndarë ndërmjet ortakëve të shoqërisë është:

- a. Ortaku themelues Shoqëria "ALFAZED"Sh.P.K, zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë të përgjithëshme 10.000 Lekë, që përben 50 %, të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - b. Ortaku themelues Shoqëria "PRIMO GROUP"Sh.P.K , zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithëshme 10.000 Lekë, që përben 50%, të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme, të paluajtshme apo të drejta).

## **Kreu IV**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

#### **Neni 8.**

**8.1-**Organi kryesor vendimarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Mbledhjet e Asamblesë thirren jo më pak se dy herë në vit.

**8.2-**Asambleja e Përgjithëshme merr vendime të vlefshme me arritjen e pjesmarrjes parashikuar në Nenin 86, 87, të Ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

8.3-Mbledhja drejtohet nga Administratori i Shoqërisë. Zakonisht emërohet nga pjesëmarrësit një sekretar, me përjashtim të rasteve kur procesverballi duhet mbajtur nga noteri, sipas ligjit .

8.4-Vendimet e mbledhjes fiksohen në proces-verbalin e firmosur nga Administratori dhe sekretari, ose noteri. Në proces-verbal duhet të përmbledhen, me kërkesën e bërë prej tyre, deklaratat e bëra prej ortakëve. Vendimet e mbledhjes, të marra në përputhje me ligjin, Aktin e Themelimit, ose Statutin lidhin të gjithë ortakët e Shoqërisë, megjithëse nuk kanë diskutuar ose kundërshtuar.

## Kreu V

### ADMINISTRIMI

#### Neni 9.

9.1-Administrimi i shoqërisë do të bëhet në përputhje me Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti. Administrator i shoqërisë emërohet z. Besnik Paluca, atësia Prend, shtetas Shqiptar, lindur në Kalivaç, Lezhë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga "Mine Peza"; Njësia Administrative Nr. 9; Tiranë, lindur më 28/02/1982. Afati është pesë vjet nga data e regjistrimit në QKB.

## Kreu VI

### DISPOZITA TË TJERA

#### Neni 10.

10.1-Fitimi i realizuar nga shoqëria, mbas shlyerjes së detyrimeve ligjore, do tu mbetet Ortakëve, sipas përqindjeve të vendosura në kapitalin themeltar të shoqërisë.

10.2-Mosmareveshjet ndërmjet ortakëve, nëqoftëse nuk zgjidhen me mirekuptim, do të gjykohen nga Gjykata kompetente shqiptare.

10.3-Ky Akt, hartohet në kater kopje origjinale në të njëjtën vlerë ligjore. Akti hartohet në gjuhën shqipe, kuptohet, nënshkruajne me vullnet të lire, të plote sipas ligjit. Une Noteri e vertetoj këtë fakti sipas Ligjit.

## ORTAKËT

Shoqëria "ALFAZED" Sh.P.K  
Perf. ( \_\_\_\_\_ )

*Shefqat Jeli*



Shoqëria "PRIMO GROUP Sh.P.K  
Perf. ( ERVIS RIBOLLI )

*ER*

